

Legjionaret/ Kace percan greket e PAOK

nga AlbaniaSoccer

E mërkurë, 25 Shtator 2013 21:16



Ergys Kace është personazhi i momentit. Një numër i madh problemesh për të me greket e kanë bërë mesfushorin nga Korça të gjejë veten përfundimisht në mediat shqiptare dhe greke. Vendimi i PAOK për ta lënë jashtë skuadër futbollistit të talentuar ka sjellë një rremujë në Greqi. Trajneri i PAOK ka dalë kundër klubit duke kërkuar rikthimin në skuadër të lojtarit . Huub Stevens, i cili nuk arrin të zberthejë një histori të tillë kundër djaloshtit 20-vjeçar, ndaj të cilit vazhdon të ushtrohet një presion i madh edhe pse ai ka dalë hapur duke kërkuar falje për gjestin e tij. Sipas faqes së specializuar Sportdog.gr, Stevens i kundërvihet shoqërisë, duke e çësuar të pakuptueshëm vendimin për ta pezulluar lojtarin kuqezin. Tekniku beson se djaloshtit i duhet dhënë edhe një mundësi, pasi është një lojtar i ri dhe shumë i talentuar.